

RREGULLAT E GARES- 2008

IKJE

HYRJE

NISI MASA, është organizatë me seli në rr. Faubourg Saint-Denis Br. 99, 75010 Paris, Francë, që organizon garën e vitit 2008, qëllimi i së cilës është t'u jap ndihmë skenaristëve të rinjë Evropian (të filmave të shkurtër) drejtë prodhimit të punës së tyre.

1 - KUSHTET E Pjesëmarrjes

1.1 - GARUESIT

Nga data 15/05/2008, garat do të janë të hapura për të gjithë ata të cilët në ditën e dërgesës së kandidaturës së saj/tij qëndrojnë ose kanë shtetësi të këtyre shteteve: Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Finlandë, Francë, Gjermani, Hungari, Holandë, Itali, Kosovë, Maqedoni, Poloni, Rusi, Rumani, Spanjë, Suedi, Turqi dhe Çeki. Ai/ajo duhet ti ketë prej 18-28 vjet në ditën e mbylljes së garave më 31/07/2008.

1.2 - Procedurat dhe dërgesa e skenarit

Tema e përgjithshme e garave është "Ikje". Skenarët garues duhet të jenë në këtë temë.

Personat të cilët dëshirojnë të garojnë duhet ta dërgojnë një dokument i cili do t'i përmbajë këta artikuj, tek NISI MASA grupi e cili gjendet në shtetin e tij, para datës së kryerjes së garave (31/07/2008):

- **1 fletë paraqitje**, që mund të gjenden në sajtin www.nisimasa.com në pjesën "Regjistrimi", të plotësohet drejt (po nëse kanë probleme me të shtypurit, një dokument i cili i posedon informatat të cekura në fletë paraqitje).

- **1 kopje të skenarit** të cilën garuesi dëshiron t'ia dorëzon jurisë, duke marrë parasysh që vetëm një skenar për garues është i lejuar (shiko kushtet e posaçme në tekstin e mëtutjeshëm). Formati i zakonshëm i skenarit duhet të respektohet si dhe rregullat e përgjithshme (shiko treguesit e përgjithshëm të mënyrës së shkrimit të skenarit).

- **1 kopje e skenarit** duhet të dërgohet në RTF dokument (rich text format) -nëpërmes e-mailit nacional të NISI MASA grupit.

Të gjitha dokumentet jo të kompletuara do të refuzohen, e po ashtu vlen edhe për fletë paraqitjet të dorëzuara me dokumente.

Autori mund të dërgoj **shpjegime shtesë** në më së shumti një faqe, në të cilën i shpjegon arsyet për të cilat ai/ajo ka vendosë të marrë pjesë në garë dhe në çfarë mënyre skenari i tij/saj merret me çështjen e temës "Ikje".

1.3 - Skenari

Skenarët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

- Skenarët duhet të janë të shkruara në njërin nga gjuhët zyrtare: Shqipe, Bullgare, Angleze, Kroate, Finlandeze, Frëngjishte, Gjermane, Hungareze, Maqedone, Italishte, Letonie, Norvegjeze, Polake, Rumune, Serbe, Spanjolle, Suedeze, Turke.

- skenarët duhet të janë të shtypur dhe jo më shumë se 20 000 shenja (duke mare parasysh edhe shenjat e pikësimit).

- skenarët duhet të janë plotësisht origjinal, nuk guxojnë të kenë pjesë të huazuara nga skenarët tjerë, në asnjë mënyrë, të cilat janë të mbrojtura me të drejta autoriale ose në cilën do mënyrë tjetër dhe nuk guxojnë t'i shkulin të drejtat e palës së tretë, në asnjë mënyrë.

2 - ZGJEDHJA NË NIVEL NACIONAL

Në secilin nga shtetet në të cilin do të mbahen garat, NISI MASA grupi lokal do ta formoj komisionin i cili do të merret me gara dhe i cili do t'i përzgjedh dy skenarë, që do të jenë në gjendje të garojnë në nivel ndërkombëtar sipas rregullave të shpjeguara në nenin 3. Kjo juri nacionale, nën mandatin NISI MASA, do të përbëhet nga grupet të cilat janë më pak se tre persona nga 18-35 vjet dhe të cilat do t'i përzgjedhin dy skenare për procesin përfundimtarë të zgjedhjes në nivel ndërkombëtarë.

Juria nacionale do ta bëjë përzgjedhjen në afat kohor nga dita e përfundimit të garave (31/07/2008) deri në përfundimin e zbatimit të zgjedhjes (15/09/2008).

Kjo përzgjedhje përmban votimin në të cilin do të marrin pjesë të gjithë anëtarët e jurisë, pas diskutimit. Vendimi i jurisë do të jetë definitiv, përzgjedhja e tyre nuk do të diskutohet. Dy skenarë të përzgjedhura në këtë mënyrë nga të gjitha juritë nacionale, do t'i dorëzohen Rrjetit NISI MASA më se largu deri në ditën e fundit të aprovimit të zgjedhjes (15/09/2008).

3 - ZGJEDHJA NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

NISI MASA do ta formon jurinë ndërkombëtare, në përbëje të së cilës do të përfshihen anëtarët e të gjitha grupeve nacionale NISI MASA, me konsultime shtesë me një ose më shumë profesionalistë filmi (përfaqësuesin G.R.E.C, producentë, regjisorë, skenaristë, kritikë etj.).

Anëtarët e jurisë ndërkombëtare do të takohen përgjatë muajit Nëntor në Kars, Turqi, që të diskutojnë dhe zgjedhin tre skenarë të cilët do t'i fitojnë shpërblimet NISI MASA për vitin 2008.

Vendimet e jurisë ndërkombëtare janë të përbashkëta dhe të fshehta. Vendimet do të finalizohen dhe publikohen në natën mbyllëse të takimit të jurisë në nëntor 2008. Juria nuk do të ketë nevojë të jap shpjegime për vendimin e saj, ndërsa vendimi do të jetë definitiv.

Lista e fituesve do të publikohet zyrtarisht me prezentim në internet faqen e NISI MASA (www.nisimasa.com) dhe në mjetet e informimit publik.

Fituesit në nivel Evropian do të informohen personalisht për rezultate me anë të postes. NISI MASA nuk ka obligim t'i kthej kopjet garuesve që nuk kanë fituar.

4 - SHPËRBLIMET

Tre shpërblime do të ndahen nga NISI MASA, GARA E SKENAREVE EVROPIANE PËR VITIN 2008. Të tre çmimet NISI MASA kanë të bëjnë me mbështetjen e prodhimit të ofruar nga rrjeti NISI MASA. Në bashkëpunim me organizatat antare të shteteve , NISI MASA do të prodhojë tre filmat në bashkëpunim me produksionet filmike.

Të gjitha aspektet e xhirimit (paisjet, lokacioni, ekipi teknik dhe artistik, etj) do të jenë rezultat i një marrëveshjeje në mes NISI MASA dhe organizatës/produksioni, varësisht prej specifikave të skenarit dhe kushteve teknike e financiare të filmimit.

Po ashtu çmimet kryesore, 10 skenaristët finalistë do të ftohen të marrin pjesë në puntorisë e skrip-shkruarjes organizuar nga NISI MASA në Ande and Clermont-Ferrand, Francë, në Janar të vitit 2008.

Përgjatë puntorisë skenaristët do të kenë rastin të pubnojnë në skenaret e tyre, me ndihmën e tutorëve profesionist dhe gjithashtu të prezantojnë skenaret e tyre pranë producentëve ndërkombtarë përgjatë Festivalit të filmit të shkurtë Clermont-Ferrand.

5 - ORIJENTIMI DHE REALIZIMI I SHPËRBLIMEVE

Organizatat prodhuese duhet të garantojnë se faza e post-produksionit të filmave duhet të mbarojë para se të mbarojë viti 2008.

Të gjitha aspektet e xhirimit (paisjet, lokacioni, ekipi teknik dhe artistik, etj) do të jenë rezultat i një marrëveshjeje në mes NISI MASA dhe organizatës/produksionit dhe fituesit, varësisht prej specifikave të skenarit dhe kushteve teknike e financiare të filmimit.

Organizatat prodhuese/ produksioni bashkë me NISI MASA do të ndajnë autorësinë e plotë të filmave të prodhuar, bartur nga fituesit të cilët duhet të vet-marrin përsipër atë.

Filmat duhet që, në fillim dhe të mbarim, ta theksojnë këtë fjali: "SHPËRBLIMI I GARËS PËR SKENAR- NISI MASA 2008".

Në marrëveshjen me organizatat prodhuese, NISI MASA do ta ketë të drejtën e emetimit të filmave në kuadër të aktiviteteve të saja.

6 - TË NDRYSHME

7.1 - Publikimi i rregullave

Rregullat ekzistuese si dhe ndërrimet potenciale, do të publikohen në sajtin zyrtar të RRJETIT NISI MASA, www.nisimasa.com, në pjesën e përkushtuar NISI MASA, GARA EVROPIANE PËR SKENARË.

7.2 - Përgjegjësitë e organizatorit

Si organizator i garave, NISI MASA garanton që garat do të zhvillohen në përputhje me rregulla. Ndërsa, ajo nuk do të jetë përgjegjëse për rreziqet e mundshme të cilat kanë të bëjnë me xhirimin e filmit.

NISI MASA rezervon të gjitha të drejtat për të ndryshuar rregullat dhe rregulloret në ndonjë kohë, pa njoftim paraprak.

7.3 - Kompjuteri dhe të Drejtat

Në përputhje me ligjin e Francës (06/01/1978) për kompjuterë, dokumentet dhe të drejtat nga

06/01/1978, garuesit do të informohen se, (pos, nëse ata i kundërvihen asaj), të dhënat personale të cilat do të cekën në listat e paraqitjes dhe dokumenteve plotësuese, do të shfrytëzohen vetëm për organizmin e NISI MASA, GARES EVROPIANE PËR SKENARË 2008, dhe të garave që pasojnë, NISI MASA mbetet adresa e tyre e vetme.

Të gjithë garuesit kanë të drejtë, në përputhje me nenin 34 të ligjit të cekur më lartë, pjesëmarrjeje, komunikimit dhe shkëmbimit të dhënave nominale të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me ta.

7.4 - SHITESAT

Shtesat konsiderohen pjesë e rregullave të paraqitura.

7.5 - Gjuha

Gjuhët zyrtare të garave janë të cekura në paragrafin 1.3. Skenari i shkruar në ndonjë gjuhë tjetër, nuk do të marrë pjesë në gara.

Këto rregulla janë në dispozicion në gjuhët e ndryshme. Në rast të interpretimit kontrovers dhe /ose përdorimit të versioneve të ndryshme, versioni në gjuhën Angleze do të jetë ai zyrtar.

7.6 - Ligji në fuqi

Rregullat e cekura si dhe mundësia e mosmarrëveshjes në lidhje me rregulla, direkt ose indirekt, i nënshtrohen Ligjit të Francës.